



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:900009  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05499863

KPPP.nr.473/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit NTP KGT në Prishtinë, me NRB: 70004006, kundër debitorit Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.1/2019 të datës 15.01.2019, të Përmbaruesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 21.03.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.1/2019 i datës 15.01.2019, i nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.1/2019 të datës 15.01.2019, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.03/18 të datës 16.05.2018, me të cilin e ka detyruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit shumën prej 6,534.00 Euro, me kamatë prej 8%, duke filluar prej datës 15.06.2018 e deri në ditën e pagesës si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se kreditori asnjëherë nuk i ka sjellur faturat tek debitori, dhe një gjë e tillë shihet se të njëjtat nuk janë të firmosura. Ka theksuar se urdhri për përmbarim P.nr.1/19 i datës 15.01.2019 i lëshuar nga Përmbaruesi Privat, është në kundërshtim me nenin 23 dhe nenin 24 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit, ndërsa të anulohet urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat dhe të shfuqizohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka dhënë shpjegim, në të cilin ka theksuar se nuk është i vërtetë arsyetimi i cekur në prapësim, ngase me rastin e dorëzimit të materialit e kemi dorëzuar edhe faturën. Ka shtuar se kjo praktikë ka vazhduar 6 vite, dhe se MASHT vetëm fletëpranimet i ka nënshkruar pasi që të njëjtit arsyetohen se duhet të formohet komisioni, dhe në këtë rast vetëm fletëpranimi është nënshkruar, ndërsa kur jemi interesuar për pagesë, zyrtarja dhe menaxherja e kontratës vazhdimisht ka deklaruar se është shkuar për pagesë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.206/19 të datës 28.05.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1375/2022 të datës 20.01.2023 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, duke e anuluar vendimin e shkallës së parë PPP.nr.206/2019 të datës 28.05.2021, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë shkresat e lëndës dhe nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ndërsa e ka udhëzuar që në ri procedurë të vlerësojë në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*” dhe me paragrafin 3

të njëjtit nen, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*“, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.03/18 e datës 16.05.2018, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit-debitorit.

Duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmëris, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Në rastin konkret, gjykata konstatoi se përkundër faktit se fletë dërgesa nr.000003 e datës 14.05.2018 dhe fletë dërgesa nr.000003a e datës 16.05.2018 të cilat janë bashkëngjitur në shkresat e lëndës, përmbajnë nga një nënshkrim tek pranuesi i faturave, megjithatë pa vulën e pranimin të debitorit në këto fletëdërgesa apo në faturën nr.03/18 të datës 16.05.2018 për gjykatën nuk është e mjaftueshme për të identifikuar se a është bërë dorëzimi i rregullt i faturës lëndore tek debitori-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në mënyrë që debitori të njoftohet me detyrimin që buron nga e njejta.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbartimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike  
KPPP.nr.473/23, më datë 21.03.2024

Gjyqtari  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.